




Planuar / Doretuar Primjeño/Prodato Received/Delivory	27-12-2022	viti god year	
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SIK/MS/TK	8490/2022		1/6



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1001/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1001/2022 të datës 11.11.2022 të parashtruar nga ankuesi

kundër organit të punësimit Ministrisë Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në çështjen juridike "Kontestim Konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 27.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1001/2022 e datës 11.11.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. MBETET ne fuqi Njoftimi për kandidatin fitues i nxjerr nga Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë i datës 18.10.2022.

A r s y e t i m

Ankuesi _____ më datë 11.11.2022 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar nën shenjë A.nr.1001/2022 me numër protokoll 7037/2022, me pretendimin që të anulohet njoftimi i DBNJ në Ministrinë e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe ti mundësohet ti nënshtrohet procedurës së intervistimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 01.12.2022 ankesën e ankuesit e ka dërguar tek Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për përgjigje në ankesë. Ndërsa më datë 08.12.2022 me numër protokoll 7778/2022 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.protokolli 7037/2022 të datës 11.11.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail nga Arkiva Mint për L.H. etj i datës 10.10.2022; Vendim i Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë i datës 14.10.2022; Njoftim për kandidatin fitues i datës 18.10.2022; E-mail nga S.S. për L.H. i datës 28.10.2022; E-mail nga Simbnj për S.S. i datës 06.10.2022; E-mail nga L.H. për A.D. etj. i datës 18.10.2022; E-mail nga A.D. për F.L. i datës 18.10.2022; E-mail nga L.H. për R.B. i datës 18.10.2022; E-mail nga V.D. për L.H. i datës 11.10.2022; E-mail nga L.H. për V.D. i datës 11.10.2022; E-mail nga A.D. për L.H. i datës 11.10.2022; E-mail nga L.H. për A.D. i datës 10.10.2022; E-mail nga A.D. për L.H. i datës 10.10.2022; E-mail nga A.D. për L.H. i datës 03.10.2022; E-mail nga A.D. për L.H. i datës 26.10.2022; E-mail nga L.H. për F.L. i datës 26.10.2022; E-mail nga F.L. për L.H. i datës 25.10.2022; E-mail nga L.H. për A.D. i datës 04.10.2022; E-mail nga F.L. për L.H. i datës 25.10.2022; E-mail nga A.D. për L.H. i datës 18.10.2022; E-mail nga L.H. për A.D. etj. i datës 18.10.2022; E-mail nga A.D. për F.L. i datës 18.10.2022; E-mail nga A.D. për F.L. i datës 18.10.2022; E-mail nga F.L. për A.D. i datës 18.10.2022; E-mail nga A.D. për F.L. i datës 18.10.2022; E-mail nga A.D. për L.H. i datës 11.10.2022; E-mail nga L.H. për A.D. i datës 10.10.2022; E-mail nga A.D. për L.H. i datës 10.10.2022; E-mail nga A.D. për L.H. i datës 03.10.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 01.12.2022; E-mail nga A.D. për C.Z. i datës 20.12.2022; E-mail nga C.Z. për A.D. i datës 20.12.2022; Përgjigje në ankesë me numër protokolli 7778/2022 i datës 08.12.2022; Akt Emërim i S.S. i datës 15.04.2019; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 05.05.2017; Konkurs për lëvizje brenda kategorisë për pozitën "Inspektor i Tregut" i datës 19.08.2022; Njoftim i datës 19.08.2022; Njoftim i datës 15.09.2022; Lista e aplikantëve Simbnj; Vendim me nr. 5603-03 i datës 15.09.2022; E-mail nga A.D. për L.H. i datës 19.09.2022; E-mail nga B.B. për S.S. i datës 19.09.2022; E-mail nga B.B. për F.L. i datës 19.09.2022; E-mail nga B.B. për A.H. i datës 19.09.2022; E-mail nga B.B. për S.A. i datës 19.09.2022; Njoftim i datës 19.08.2022; Ankesë me nr. 6141-19 i datës 10.10.2022; Vendim me nr. 5643-02 i datës 19.09.2022; E-mail nga Arkiva Mint për S.S. etj. i datës 18.10.2022; Vendim i datës 14.10.2022; Forma individuale për intervistë e datës 30.09.2022; Forma individuale për intervistë e datës 03.10.2022; Forma individuale për intervistë e datës 30.09.2022; Forma individuale për intervistë e datës 30.09.2022; Renditja përfundimtare e kandidatëve Simbnj; Njoftim për kandidatin e suksesshëm i datës 06.10.2022; Njoftim për kandidatin fitues i datës 18.10.2022; Konfirmim për përfundimin e konkurimit Simbnj i datës 18.10.2022; E-mail nga A.D. për F.L. i datës 18.10.2022; E-mail nga R.B. për A.D. i datës 31.10.2022; E-mail nga E.A. për N.Sh. i datës 28.10.2022; E-mail nga A.D. për R.B. etj. i datës 28.10.2022; E-mail nga R.B. për A.D. i datës 28.10.2022; E-mail nga R.B. për A.D. i datës 17.10.2022; E-mail nga A.D. për R.B. i datës 14.10.2022; E-mail nga R.B. për A.D. i datës 14.10.2022; E-mail nga L.H. për V.D. i datës 11.10.2022; E-mail nga A.D. për L.H. i datës 11.10.2022; E-mail nga L.H. për A.D. i datës 10.10.2022; E-mail nga A.D. për L.H. i datës 10.10.2022; E-mail nga A.D. për L.H. i datës 03.10.2022; Raporti për prezencën në punë prej datës 26.09.2022 deri 30.09.2022; Akt Emërim i F.L. i datës 24.10.2022; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 02.08.2022; E-mail nga A.D. për L.H. i datës 03.10.2022; E-mail nga A.D. për L.H. i datës 06.10.2022; E-mail nga L.H. për A.D. i datës 04.10.2022; E-mail nga L.H. për A.D. i datës 10.10.2022; E-mail nga A.D. për L.H. i datës 10.10.2022; E-mail nga A.D. për L.H. i datës 03.10.2022; E-mail nga A.D. për L.H. i datës 11.10.2022; E-mail nga L.H. për A.D. i datës 18.10.2022; E-mail nga A.D. për F.L. i datës 18.10.2022; E-mail nga A.D. për L.H. i datës 18.10.2022; E-mail nga A.D. për L.H. i datës 26.10.2022; E-mail nga L.H. për F.L. i datës 26.10.2022; E-mail nga F.L. për L.H. i datës 25.10.2022; Aplikacioni i S.A. i datës 09.09.2022; Diplomë nga Akademia e Kosovës për Siguri Publike e S.A. i datës 05.07.2022; Certifikatë nga ICMTC për S.A. e muajit Prill 2022; Certifikatë nga ERC për S.A.; Certifikatë nga ERC për S.A.; Certifikatë nga Council of Europe për S.A. i datës 11.03.2022; Mirënjohje nga SHKK Ministria e Drejtësisë për S.A. e vitit 2021; Certifikatë nga Policia e Kosovës për S.A. i datës 10.12.2021; Certifikatë nga SHKK për S.A. i datës 12.11.2022;

Certifikatë nga Eulex për S.A. e muajit Prill 2022; Certifikatë nga SHKK për S.A. i datës 31.01.2020; Mirënjohje nga SHKK Ministria e Drejtësisë për S.A. e vitit 2019; Certifikatë nga Akademia e Kosovës për Siguri Publike e S.A. i datës 18.10.2019; Mirënjohje nga SHKK për S.A. i datës 31.12.2018; Certifikatë nga SHKK për S.A. i datës 25.10.2013; Certifikatë nga OSBE për S.A. i datës 29.10.2021; Kontratë Pune për kohë të pacaktuar (personeli korrektues) e S.A. e datës 15.07.2020; Vendim i SHKK me nr. 0448 i datës 25.02.2021; Vendim i SHKK me nr. 0668 i datës 18.05.2021; Vendim i SHKK me nr. 0679 i datës 21.05.2021; Vendim i SHKK me nr. 0865 i datës 21.07.2021; Vendim i SHKK me nr. 0946 i datës 23.08.2021; Vendim për ndryshim plotësimin e vendimit nr. të prot. 0054 të datës 19.01.2022; Vendim i SHKK me nr.0054 i datës 18.01.2022; Vendim i SHKK i datës 18.02.2021; Letërnjoftim i S.A.; Vlerësim i rezultateve në punë për vitin 2021 i S.A. i datës 24.01.2022; Vlerësim i rezultateve në punë i datës S.A. i datës 23.12.2020; Vërtetim nga SHKK për S.A. i datës 13.05.2022; Aplikacioni i F.L. i datës 07.09.2022; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" për F.L. me nr. 3208 i datës 16.09.2014; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" për F.L. me nr. 523 i datës 12.05.2014; Certifikatë nga AAB Riinvest për F.L. e muajit gusht 2011; Certifikatë nga eco për F.L. 28.01.2011; Certifikatë nga eco për F.L. e muajit Maj 2011; Certifikatë nga pcmg për F.L. i datës 28.09.2002; Certifikatë nga EU për F.L. e muajit shkurt 2022; Diplomë nga The Cambridge School për F.L. i datës 17.05.2002; Certifikatë nga Britanica për F.L.; Certifikatë nga ICAP për F.L. i datës 07.03.2013; Kontratë Punësimi e F.L. e datës 01.11.2002; Përshkrimi i detyrave të vendit të punës; Shtojca rregullat e mirësjelljes së shërbimit civil; Kontratë e marrëdhënies së punës e F.L. i datës 03.09.2003; Përshkrimi i detyrave të vendit të punës; Kontratë e marrëdhënies së punës e F.L. i datës 03.01.2004; Përshkrimi i detyrave të vendit të punës; Kontratë e marrëdhënies së punës e F.L. i datës 03.01.2006; Përshkrimi i detyrave të vendit të punës; Rekomandimi për përtëritjen e kontratës e F.L. i datës 29.11.2005; Kontratë e marrëdhënies së punës e F.L. i datës 15.01.2008; Përshkrimi i detyrave të vendit të punës; Rekomandimi për përtëritjen e kontratës e F.L. i datës 09.08.2007; Kontratë e marrëdhënies së punës e F.L. i datës 04.08.2008; Përshkrimi i detyrave të vendit të punës; Kontratë e marrëdhënies së punës e F.L. i datës 22.09.2010; Përshkrimi i detyrave të vendit të punës; Rekomandimi për përtëritjen e kontratës e F.L. i datës 22.09.2010; Akt Emërim i F.L. i datës 28.01.2013; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 02.02.2012; Ndryshim dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i F.L. i datës 04.09.2014; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 03.09.2014; Ndryshim dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i F.L. i datës 23.09.2019; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 05.05.2017; Letërnjoftim i F.L.; Vërtetim i F.L. i datës 29.08.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i F.L. i datës 31.01.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i F.L. i datës 10.02.2021; Aplikacioni i A.H. i datës 07.09.2022; Diplomë për kryerjen e shkollës së mesme profesionale e A.H. i datës 29.05.2002; Diplomë nga Universiteti AAB për A.H. me nr. 452/09 i datës 09.06.2009; Diplomë nga Universiteti i Sarajeves me nr. 54-P/09 i datës 17.12.2009; Certifikatë nga Kolegji Fama për A.H. i datës 03.05.2012; Diplomë nga Kolegji Fama për A.H. me nr. 060/0113 i datës 09.01.2013; Diplomë nga Kolegji AAB për A.H. me nr. 1997/18 i datës 01.11.2018; Certifikatë nga IKAP për A.H. i datës 17.03.2022; Certifikatë nga IKAP për A.H. i datës 21.09.2018; Certifikatë nga IKAP për A.H. i datës 21.09.2018; Certifikatë nga IKAP për A.H. i datës 27.04.2018; Certifikatë nga IKAP për A.H. i datës 29.03.2018; Certifikatë nga IKAP për A.H. i datës 29.09.2015; Diplomë nga Cyber School për A.H. i datës 16.03.2001; Certifikatë nga ELT course për A.H. i datës 15.09.2012; Certifikatë nga Kolegji Fama për A.H. i datës 05.06.2011; Certifikatë nga IKAP për A.H. i datës 29.04.2022; Ndryshim dhe Plotësim i Akt Emërimit të A.H. i datës 13.09.2018; Akt Emërim i A.H. i datës 10.11.2021; Vendim për A.H. i datës 03.11.2021; Vendim për A.H. i datës 15.01.2018; Vërtetim i marrëdhënies së punës i A.H. i datës 24.08.2022; Vërtetim nga Kolegji Biznesi i A.H. i datës 22.07.2014; Vërtetim nga Kolegji

Biznesi i A.H. i datës 07.09.2012; Certifikatë nga IKAP për A.H. i datës 21.09.2018; Akt Emërim i A.H. i datës 16.04.2015; Vendim me nr.14/09/15 i datës 22.04.2015; Vërtetim i marrëdhënies së punës i A.H. i datës 24.08.2022; Letër rekomandim për A.H. e muajit Dhjetor 2014; Shkresë e ARBK; Ndryshim dhe Plotësim i Akt Emërimit të A.H. i datës 23.03.2017; Diplomë nga Cyber School për A.H. i datës 16.03.2001; Letër Rekomandim për A.H. e muajit Mars 2018; Letër Rekomandim për A.H. e muajit Shtator 2017; Letër Rekomandim nga Kolegji Biznesi për A.H.; Referencë për A.H. e muajit Gusht 2022; Referencë për A.H. e muajit Dhjetor 2021; Letër Rekomandim për A.H. e muajit Dhjetor 2014; Letër Rekomandim për A.H. i datës 31.05.2012; Letërnjoftim i A.H.; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i A.H. i datës 06.01.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i A.H. i datës 31.12.2020; Vërtetim për masa disiplinore i A.H. i datës 24.08.2022; Certifikatë nga Gjykata Themelore Gjakovë e A.H. i datës 23.08.2022; Aplikacioni i S.S. i datës 13.09.2022; Id kartela e punës e S.S.; Letërnjoftim i S.S.; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i S.S. i datës 28.01.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i S.S. i datës 01.02.2021; Vërtetim i S.S. i datës 08.09.2022; Vërtetim i marrëdhënies së punës i S.S. i datës 08.09.2022; Vendim me nr. protokolli 02-8181 i datës 02.11.2020; Akt Emërim i S.S. i datës 15.04.2019; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 05.05.2017; Diplomë nga Kolegji Fama për S.S. i datës 29.09.2020; Diplomë nga Universiteti AAB për S.S. me nr. 263/11 i datës 30.03.2011; Diplomë nga Kolegji AAB për S.S. me nr. 749/21 i datës 22.06.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka shqyrtuar kompetencën lëndore dhe lejueshmërinë e ankesës, duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e pa bazuar, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji ka gjetur se Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë më datë 19.08.2022 ka publikuar konkursin për Lëvizje Brenda Kategorisë me Nr.Reference RN00009713 për pozitën "Inspektor i Tregut", ku afati për aplikim ka qenë nga data 07.09.2022 deri më datë 14.09.2022. Në këtë konkurs në bazë të listës së kandidatëve ka aplikuar dhe ankuesi, i cili në bazë të Njoftimit të datës 19.08.2022 është përfshirë në listën e ngushtë. Më datë 19.09.2022 Zyrtarja e Personelit në Ministrinë e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë përmes emailit zyrtar e ka njoftuar ankuesin për mbajtjen e intervistës me gojë për pozitën "Inspektor i Tregut". Në bazë të shkresave të lëndës ankuesi nuk ka marrë pjesë në intervistim për pozitën e lartcekur si dhe i njëjti nuk i ka njoftuar për arsyet e mospjesëmarrjes në intervistë. Pas përfundimit të rregullt të procedurës së pranimit për pozitën e lartcekur, Njësia e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ka publikuar renditjen përfundimtare të kandidatëve ku rezulton se ankuesi nuk është vlerësuar sepse nuk ka marrë pjesë në intervistë, ndërsa më datë 18.10.2022 është publikuar njoftimi për kandidatin fitues. Ankuesi edhe pse nuk ka marrë pjesë në intervistë me datë 10.10.2022 me numër protokolli 6141/19 ka parashtruar ankesë me pretendimin se pjesëmarrja në intervistë i është pamundësuar për shkak të urgjencës në inspektim dhe urdhrit nga Udhëheqësi i Drejtpërdrejtë, ankuesi në shkresat e lëndës nuk ka bashkëngjitur asnjë dëshmi se ka pasur të pa mundur të marrë pjesë në intervistë. Komisioni i Vlerësimit për Lëvizjen Brenda Kategorisë me datë 14.10.2022 ka nxjerr vendim me të cilin i ka Aprovuar si të bazuar ankesën me Nr.6141-19 të datës 10.10.2022 dhe në pikën 2 të Vendimit e ka Obliguar Njësinë e Burimeve Njerëzore të njoftoj KVLBK dhe kandidatin për intervistën me gojë për pozitën e cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pretendon që të anulohet njoftimi i DBNJ në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë në mënyrë që ti mundësohet ankuesit ti nënshtrohet procedurës së intervistimit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se vendimi i datës 14.10.2022 me Nr. protokolli 6251-19 i nxjerrë nga kryesuesja e komisionit është i pabazuar pasi që nuk ka kompetencë të shqyrtoj ankesën e ankuesit sepse Rregullorja (QRK) 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, gjatë procesit të rekrutimit lëvizje brenda kategorisë njih vetëm dy faza të ankimimit të cilat mund të parashtrohen tek KVLB sipas nenit 45 paragrafi 6 si dhe neni 50 paragrafi 1 dhe 2.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në bazë të shkresave të lëndës ka konstatuar se i njëjti ka deklaruar se nuk kam pas të mundur të marrë pjesë në intervistë pasi që në kohën e njëjtë më është kërkuar të marrë pjesë në inspektive të përbashkëta me institucione tjera të zbatimit të ligjit, por ankuesi nuk ka dhënë asnjë dëshmi lidhur me këtë që pretendon dhe se KVLB me vendimin e datës 14.10.2022 me të cilin ka Aprovuar si të bazuar ankesën me nr. 6141-19 të datës ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Rregullores (QRK) 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, gjatë procesit të rekrutimit lëvizje brenda kategorisë njih vetëm dy faza të ankimimit ku neni 45 paragrafi 6 i cili përcakton se: *6. Brenda shtatë (7) ditëve nga data e njoftimit individual, në përputhje me paragrafin 5 të këtij neni, kandidatët e njoftuar që nuk plotësojnë kushtet e aplikimit, kanë të drejtë të paraqesin ankesë të brendshme. Ankesa parashtrohet më shkrim pranë NJBNJ. Ankesa shqyrtohet nga NJBNJ dhe vendimi njoftohet brenda shtatë (7) ditëve nga paraqitja e saj.*

Lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankuesit, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në bazë të provave materiale duke u bazuar në e-mailin zyrtar të datës 20.12.2022 të Udhëheqëses të Divizionit të Burimeve Njerëzore konstaton se i njëjti nuk ka pasur si ta njoftoj ankuesin për afatin e ankesës përderisa i njëjti nuk ka marrë pjesë në intervistë me gojë dhe se i njëjti nuk posedon ankesë pas datës së njoftimit të datës 18.10.2022, ndërsa ankuesi nuk ka ofruar asnjë provë me të cilën dëshmohet se ka parashtruar ankesë të brendshme pranë Komisionit për Vlerësimin e Lëvizjes Brenda Kategorisë, ndërsa faktin se ankuesi nuk ka parashtruar ankesë të brendshme e ka konfirmuar edhe autoriteti punëdhënës në përgjigjen në ankesë të datës 20.12.2022, si rrjedhojë bazuar në këto prova, ankuesi nuk ka vepruar sipas nenit 50 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *"Kundër rezultatit të fazës të vlerësimit, çdo kandidat i interesuar, mund të paraqesë ankesë të brendshme, brenda shtatë (7) ditëve nga data e njoftimit individual. 2. Ankesa shqyrtohet nga KVLBK, dhe vendimi njoftohet brenda shtatë (7) ditëve nga paraqitja e saj", si dhe ndërlidhur me nenin 31 paragrafi 1 dhe 2 të po kësaj rregullore ku përcaktohet se "Kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil, i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtrojë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (në vijim në tekstin e kësaj Rregullore "Këshilli") . 2. Ankesa në Këshill parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës të organit përkatës që ka nxjerrë aktin apo kryer veprimin që kundërshtohet".*

Bazuar në këtë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se ankesa në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër një procesi të lëvizjes brenda kategorisë në shërbimin civil, parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës së brendshme të ankesës tek pala mund të parashtrojë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si rrjedhojë meqenëse nuk ka asnjë dëshmi që ankuesi të ketë parashtruar ankesë të brendshme tek organi i punësimit, atëherë sipas Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, kandidatit në

procedurë të lëvizjes brenda kategorisë nuk i lejohet të parashtror ankesë drejtpërdrejtë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pa i shterur procedurat e brendshme të ankimit, mbi këtë bazë ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është në kundërshtim me nenin 16 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton se: *"Para parashtrimin të ankesës në Këshill, nëpunësi civil apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar, duhet t'i ketë shteruar procedurat e brendshme të ankesave brenda organit përkatës të punësimit, nëse me ligj të veçantë nuk është përcaktuar ndryshe"*, po ashtu ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është në kundërshtim me nenin 125 paragrafi 1 dhe nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, dhe si e tillë është e papranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA ME NUMËR A.NR.1001/2022

Elakron GASHI

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore
- Arkivit të KPMSHCK-së.